



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:027587
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05380961

Ac.nr.887/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti – kryetare e kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Besnik Feka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike paditësit/propozuesit të masës së sigurimit K.H., nga Ferizaji, të cilin e përfaqëson me autorizim A.I., avokat nga Ferizaji, kundër të paditurës - kundërpropozuesës "H.... P...." SH.P.K me pronarë F.G., nga Ferizaji, Rr. " G..... S...." nr.X, të cilin e përfaqëson me autorizim F.Sh., avokat nga Ferizaji, lidhur me padinë për pasurim të pabazë, me propozim për masë të sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të propozuesit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me numër 2023:027588 të datë 05.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.02.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e propozuesit për masë të sigurisë sigurimit K.H., nga Ferizaji, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me numër 2023:027588 të datë 05.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin me numër 2023:027588 të datë 05.12.2023, ka vendosur si vijon:

I. REFUZOHET propozimi për masë të sigurimit i paditësit – propozuesit K.H., nga Ferizaj për caktimin e masës së sigurisë, i ushtruar kundër të paditurës - kundërpropozuesës "H..... P...." SH.P.K me pronarë F.G., nga Ferizaj rr. " G..... S....." nr.X, me të cilën ka kërkuar që ti bëhet

bllokimi i llogarive bankare të të paditurës "H.... P....." dhe ti ndalohet kundërpropozuesit apo personave të tretë shitja, fshehja apo tjetërsimi i të gjitha njësive banesore, lokaleve dhe garazhave të ndërtuara në parcelën P-XXXX-XXXXX-XX, si dhe çdo prone tjetër e cila evidentohet në emrin e të paditurës "H..... P....." SH.P.K apo të aksionarit të vetëm të saj F.G., të tëra këto deri në plotfuqishmërinë e kësaj çështje kontestimore, apo deri në ndonjë vendim tjetër të gjykatës.

II. DETYROHET paditësit që në t'ia paguaj të paditurit- kundërshtarit të propozimit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,015.00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjyqimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i propozuesit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj, ashtu që propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, ta aprovoj si të bazuar, ndërsa për shpenzime procedurale të detyroj kundërpropozuesin, ose ta prish të njëjtin dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se :

-Ankesa e paditësit - propozuesit të masës së sigurimit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi-propozuesi i masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tij, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar padi me datë 31.01.2023, kundër të paditurit - kundërpropozuesit "H.... P.....", me objektin e padisë për pasurim të pa bazë dhe kompensim dëmi, ndërsa me datë 11.08.2023 ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë. Në propozim dhe fjalën përfundimtare lidhur me masën e sigurisë, propozuesi ka theksuar se me kundër propozuesin kanë lidhur marrëveshjen për bashkë investim, me të cilën ka qenë e paraparë ndërtimi i 4 komplekseve banesore A, B, C dhe D, të cilat janë parapare të jenë me etazhitet B+P+8+PH, e që sipas marrëveshjes ndërmjet pronarëve të pronave dhe investitorit, tani kundërpropozueses, palëve u kanë takuar nga 22% të sipërfaqes bruto në këto objekte banesore dhe me këtë etazhitet, mirëpo sipas aneks kontratave për ndarje fizike të njësive banesore rezulton se paditësi/propozuesi është nuk është kompensuar sipas marrëveshjes, pasi që me rastin e ndërtimit të objektit afarist banesor, nga komuna nuk i është dhënë leja për ndërtimin e objektit D, ashtu që propozuesi në këtë rast është dëmtuar në sipërfaqe me një diference prej 593.12 m² të sipërfaqes mbitokësore të ndërtuar. Ku sipas llogaritjeve nga këto 593.12 përafërsisht 60 m² janë nga përdhesa apo lokalet. Ndërsa sa i përket bodrumeve-garazhave nga gjithsej 8 garazha sa është dashtë t'i marre paditësi - propozuesi i njëjti ka marre vetëm tre (3) garazha dhe atë nr.X, nr.X dhe nr.XX, mbi këtë bazë ka konsideruar se është e nevojshme caktimi i masës së sigurisë, me të cilin kundër propozuesit i ndalohet shitja, fshehja apo tjetërsimi i të gjitha njësive banesore, lokaleve dhe garazhave të ndërtuara në parcelën P-

XXXXX-XXXX-XX, si dhe çdo prone tjetër e cila evidentohet në emrin e të paditurës "H..... P....." SH.P.K apo të aksionarit të saj, ngase janë plotësuar gjitha kushte ligjore për caktimin e masës së sigurisë

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas propozimit të propozuesit, ka mbajtur seancën dëgjimore me datën 06.11.2023 dhe pas analizimit të tërësishëm të provave, me aktvendimin me numër 2023:027588 të datë 05.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, ka theksuar se gjykata pas vlerësimit të provave që gjenden në shkresave të lëndës, administrimin e provave, dëgjimin e dëshmitarëve ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit është i pa bazuar, nga fakti se nuk ekziston rreziku se caktimin e masës së sigurisë do të vështirësoheshin dukshëm realizimi i kërkesës, pasi që pala propozuese nuk ka ofruar prova të bindshme që do ta arsyetonin këtë rrezik. Gjykata ka gjetur që në këtë çështje pala propozuese nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e shkaqeve në kuptim të nenit 297 paragrafi 1 të LPK-së, në të cilën thuhet se masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bën të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos që ta tjetërsojë, ngarkojnë, fshehin apo në ndonjë mënyrë tjetër do ta vështirësojnë realizimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit. Për mënyrën e vendosjes si në aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 297 par.1 pika a) dhe b) të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me dispozitën e nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se *“Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadiës.

Meqenëse, aktvendimi ankimor përmban dispozitiv të kuptueshëm, ndërsa në arsyetim janë paraqit arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet të cilat kanë qenë me rëndësi për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore, për këtë arsye thëniet e propozuesit të

sigurimit lidhur me atë se aktvendimi ankimor është rrjedhojë e shkeljeve qenësore nga dispozitat e nenit 182 par.1 dhe 182 par.2, pika n) të LPK-së, janë të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit. Kjo për faktin se nga provat në shkresat e lëndës ka rezultuar se propozuesi i sigurimit nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së tillë do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës, për shkak të mundësisë së bartjes apo transferimit të pronës nga ana e kundërshtarit të sigurimit, po ashtu nuk ka ofruar asnjë provë materiale me të cilën do ta mbështeste këtë pretendim. Gjykata e Apelit vlerëson se në kontekstin e rrethanave të paraqitura në këtë çështje juridike kontestuese e që i referohen pretendimeve të propozuesit të sigurimit lidhur me rrezikun e mundshëm që prona të tjetërsohet apo të ndryshohet gjendja faktike dhe propozuesit do t'i pamundësohet realizimi i kërkesës së tij sipas padisë për pasurim të pazë, pa e prejudikuar përfundimin meritore të çështjes, në këtë fazë të procedurës konsiderohet i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë se caktimi i masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës nuk është i arsyeshëm dhe i bazuar.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të merre një vendim ndryshe.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.887/2024, me datë 27.02.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti d.v,